



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në Vushtri, mbajtur më 23.2.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:07**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ferit Idrizi - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- kërkoi që të mbahet 1 minutë heshtje për nder të veprës së Shefqet Popovës.

Pas mbajtjes së 1 minuti heshtjeje, vazhduan punimet e kuvendit.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- paraqiti rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë, kurse në "të ndryshme" propozoi që të futen:

a. Shqyrtimi i Informatës për pastrimin e rrugëve lokale nga bora në Komunën e Vushtrisë, gjatë periudhës emergjente.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së paraqiti dy vërejtje lidhur me rendin e ditës, duke pyetur se pika nr. 2 e rendit të ditës a është raport apo pasqyrë, pasi që në faqen e parë të materialit për pikën në fjalë

shënon “Raport...” , kurse në rend dite shënon “Informatë...”. Pastaj kërkoi përgjigje nga kryesuesi pse disa pika që janë paraparë në planin e punës për këtë muaj që të hyjnë në rend dite, nuk kanë hyrë, siç janë: Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Rini dhe Sport; Draft-Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, duke shtuar se koeficientët nuk janë bërë sipas kritereve ligjore, por janë bërë dhe akoma po bëhen sipas shijeve personale. Mandej tha se ka raste që në komunë janë dy ekonomistë, dy juristë, por që nuk i kanë të njëjtë koeficientët, prandaj është mirë që përmes një rregulloreje të harmonizohen koeficientët.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se rendi i ditës për mbledhjen e KK-së për muajin shkurt nuk koincidon me rendin e ditës për këtë muaj të paraparë në planin e punës, duke shtuar se sot është dashtë të jetë në rend dite edhe raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Rini dhe Sport, prandaj është dashtë të jetë raporti në fjalë, pasi që për dikasterin e kulturës nuk ka pas raporte të detajizuara deri sot. Gjithashtu tha se në rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, është dashtë që ta kemi një agjendë nga Drejtoria për Kulturë lidhur me përvjetorin në fjalë. Në fund kërkoi që për çdo muaj të respektohet plani i punës së kuvendit.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- sqaroi se për muajin shkurt mungojnë dy pika të rendit të ditës, njëra prej tyre është raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Rini dhe Sport, por nuk e kanë sjellur raportin në fjalë, dhe sqaroi se komiteti konsultativ e ka për obligim ta paraqesë raportin, e jo Drejtoria për Kulturë. Kurse lidhur me vërejtjen për emërtimin e pikës nr. 2 të rendit të ditës, tha se drejtorinë paraqesin informata para kuvendit, kurse kryetari i raporton kuvendit.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që pika nr. 6 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, dhe kërkoi që të silllet fillimisht një raport për mjetet e shfrytëzuara nga fondi për transfere dhe subvencione, dhe pastaj të paraqitet propozim-vendimi për shpërndarje të mjeteve tjera nga fondi në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me mungesën e paraqitjes së raportit vjetor nga Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Rini dhe Sport, tha se edhe komiteti në fjalë është i obliguar që ta paraqesë raportin vjetor. Kurse lidhur me vërejtjen për mungesën e Draft-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, tha se draft-rregullorja në fjalë është në përgatitje e sipër, edhe në bashkëpunim me “USAID-in, Demi-n”, edhe pse profesionistët kanë rekomanduar se nuk është e obligueshme të kalojë përmes kuvendit, mirëpo kur të finalizohet draft-rregullorja do t’i paraqitet kuvendit. Në fund tha se ka një interesim të veçantë për rregullimin e koeficienteve për të gjithë punëtorët e komunës.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar pikës nr. 6 të rendit të ditës, tha se duhet të trajtohet çështja në fjalë në kuvend dhe të merret vendimi, kurse raporti për të gjitha shpenzimet që janë bërë në vitin 2011 nga fondi për transfere dhe subvencione që janë dedikuar për ndihmë klubeve sportive dhe shoqatave të ndryshme, le të vijë në mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së nuk do të marrë pjesë në diskutim dhe votim të pikës nr. 6 të rendit të ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 25 vota “për”, të tjerët “abstenim” miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Informatës për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2011.
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2011/2012.
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë, (shqyrtimi i parë).
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.
7. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Informatës për pastrimin e rrugëve lokale nga bora në Komunën e Vushtrrisë, gjatë periudhës emergjente.
 - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës.
 - c. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me 27 vota “për”, të tjerët “abstenim” procesverbali i mbledhjes së KK-së, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Informatës për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2011.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me informatën në fjalë.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- tha se pasqyrat në fjalë kanë një përmirësim të dukshëm në krahasim me vitin e kaluar, dhe këto pasqyra janë punuar konform Ligjit mbi financat publike, duke respektuar standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Pastaj tha se shumica prej tyre, i kanë komentet adekuate. Gjithashtu tha se nga pasqyrat në fjalë shihet se ekzekutimi i buxhetit për vitin 2011 ka qenë i kënaqshëm, dhe shihet se ka një rritje të investimeve kapitale, rritje të të hyrave vetanake, duke shtuar se ka hapësirë edhe më të madhe për rritjen e këtyre të hyrave, pasi që janë afër 2 milionë euro llogari të paarkëtueshme të komunës. Në vazhdim duke iu referuar faqes 10, te rubrika “pranimet nga donatorët e jashtëm”, tha se në këtë rubrikë ka edhe donatorë të brendshëm, prandaj propozoi që të shënohet “pranimet nga donatorët” dhe kërkoi sqarime tek shumica e këtyre donatorëve në vlerë prej 1.000.708 €, duke pyetur se këto projekte a vazhdojnë edhe vitet e ardhshme, apo janë projekte që kanë përfunduar dhe kjo shumë është paguar për punë kryesit. Ndërsa në faqe nr.12 paraqiti vërejtje tek rritja për 15.44 % të shpenzimeve për mallra dhe shërbime krahasuar me vitin 2010, sidomos tek rritja e shpenzimeve prej 50.000 € për derivate në krahasim me vitin e kaluar, kurse kërkoi që në të ardhmen të ketë një rritje më të madhe të subvencioneve dhe transferet për financimin e sportit, rinisë dhe kulturës. Gjithashtu te investimet kapitale në faqe nr. 14 shihet një rritje prej 21.30 %, por kërkoi që te investimet kapitale komuna t'i mbikëqyrë në rastin e pranimet të projekteve të kryera, duke aplikuar kritere standarde me qëllim që të ruhet cilësia e investimeve, duke shtuar se cilësia e investimeve kapitale dhe pasasë së qytetarëve nëpër këto projekte është shumë e dobët. Në vazhdim kërkoi sqarime

lidhur me pozicionin “kapital tjetër” në vlerë prej 602.000 €, duke pyetur çka pasqyron pozicioni në fjalë. Ndërsa te “shpalosja e detyrimeve të komunës”, paraqiti vërejtje tek “sigurimi i automjeteve”, duke thënë që një autoshkollë nuk mund të bëjë sigurimin e automjeteve të komunës, pasi që për sigurim të automjeteve janë të licencuara kompanitë e sigurimeve, dhe në rastin konkret tenderin për sigurimin e automjeteve e ka fituar kompania e sigurimeve “Siguria”. Mandej duke iu referuar faqes nr. 30, tha se është një shumë rreth 2 milionë euro e painkasuar, dhe dominon shuma e borxhit nga tatimi në pronë, prandaj edhe në mbledhjen e KPF-së ka kërkuar nga kryetari i komunës formimin e komisionit, i cili do të bëjë rivlerësimin e pronave individuale dhe afariste, pasi që ka ndryshim të madh në hapësira, dhe shtoi se ka hapësirë të madhe për mbledhjen më të madhe të të hyrave nga tatimi në pronë. Gjithashtu te lejet ndërtimore është një shumë e vogël, e cila nuk është reale, pasi që ka shumë ndërtime pa leje, të cilat nuk iu kanë përgjigjur komunës. Në fund duke iu referuar rekomandimit 10, tha se në këtë drejtim nuk është ndërmarrë asgjë, prandaj kërkoi që Auditori i Brendshëm ta luaj rolin e vet duke i audituar rregullisht çdo tre muaj pasqyrat financiare të komunës.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar pasqyrave në fjalë, tha se ka rritje të buxhetit, të të hyrave, por kjo rritje i ka disa karakteristika te struktura, duke shtuar se të hyrat vetanake për këtë vit participojnë në buxhetin e tërësishëm vetëm me 9.34 %. Kurse shpenzimet kapitale dhe të hyrat vetjake kanë shënuar ngritje. Pastaj tha se te raporti në fjalë shihet një jokonsistencë e strukturës së zërave, dhe shtoi se komentet e paraqitura duhet ta përfshijnë çështjen esenciale. Ndërsa aty ku thuhet se “për shkak të mungesës së buxhetit nuk janë kryer disa pagesa”, propozoi që të thuhet “për shkak të mungesës së planifikimit të mirëfilltë”. Në vazhdim paraqiti vërejtje tek detyrimet kontingjente, ku sipas pasqyrave janë vetëm 55.580 € detyrime, ndërkaq në pasqyra është dashtë të figurojë shuma rreth 1.200.000 € si detyrime kontingjente, prandaj nga kjo nënkuptohet që detyrimet kontingjente nuk pasqyrojnë realitetin, dhe shtoi se është një rrezik që në këtë vit rreth 1 milion euro të tërhiqen në dëm të komunës me vendime gjyqësore. Gjithashtu tha se pjesa më e zyrtë e këtij raporti është klasifikimi i pasurive, pasi që ka gabime trashanike. Në fund i apeloj kryetarit të komunës dhe menaxhmentit që të marrin masa konkrete që të përmirësohen pasqyrat në fjalë.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- duke iu referuar vërejtjeve të paraqitura nga anëtarët e kuvendit, tha se në vitin 2011 komuna ka startuar me regjistrimin e pasurisë dhe të gjitha UOP-të (Urdhër Obligim Pagesat) që kanë të bëjnë me kapitalet janë evidentuar në modulën e pasurisë. Pastaj tha se lidhur me evidentimin e pasurisë dhe futjen e tyre në modulën e pasurisë kanë pasur probleme të gjitha komunat e Kosovës, pasi që në vitet e kaluara të gjitha të dhënat janë mbajtur në mënyrë manuale në programin e kompjuterit “Excel” dhe të njëjtat nuk janë futur në sistemin e modulit të pasurisë. Gjithashtu tha se janë certifikuar dy zyrtarë për modulën e pasurisë, prandaj në vitin 2011 kanë filluar dhe janë në fazën finale të futjes të të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me pasurinë. Në fund lidhur me detyrimet kontingjente, tha se të gjitha detyrimet në fjalë janë prezantuar në pasqyrat financiare.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar sqarimeve të drejtorit për buxhet dhe financa, tha se pasqyrat financiare paraqesin një mospërputhshmëri me vitet e kaluara, duke shtuar se të njëjtat janë skandaloze, prandaj kërkoi që për vitet e ardhshme në masë të duhur të përmirësohen.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- duke iu përgjigjur vërejtjeve të R.Ramajt, tha se në vitet 2009 dhe 2010 të gjitha të dhënat kanë qenë të futura në manual, por nuk kanë qenë të futura në sistem të pasurisë, në mungesë të certifikimit të zyrtarëve të pasurisë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar i LDK-së i propozoi kryetarit të komunës që për vitin 2012 ta paguan një kompani profesionale për

vlerësimin e aseteve, duke shtuar se përndryshe asnjëherë komuna nuk do të ketë asete reale. Në fund tha se që disa vite komuna është dëshmuar që nuk ka kapacitete për të bërë vlerësimin e aseteve.

3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2011/2012.

Qerim Selimi, drejtori i Drejtorisë për Arsim- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me informatën në fjalë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në shkollat e mesme suksesi është i dobët, veçmas në dy shkollat e mesme profesionale, dhe shtoi se do të ishte më mirë që kjo informatë të plotësohej edhe më këto elemente: titulli i informatës do të duhej të ishte "Informatë për përfundimin e mësimit", pasi që mësimi është koncept më i gjerë. Pastaj tha se tabela nr. 4 është gjysmake. Gjithashtu edhe tabela nr. 7 është gjysmake, pasi që në këtë tabelë janë paraqitur mungesat e vetëm 6 shkollave, por është dashë të paraqiten në mënyrë të thukhtë mungesat e arsyeshme dhe të paarsyeshme të arsimtarëve për secilën shkollë, duke përfshirë edhe mungesat e edukatoreve të çerdhes. Në vazhdim paraqiti mangësitë e informatës në fjalë, duke thënë se: mungon komenti për realizimin e planprogramit në gjysmëvjetorin e parë; mungon informata se a është shpërblyer ndonjë nxënës apo arsimtar; nuk dihet a është marrë ndonjë masë disiplinore për nxënësit që kanë shumë mungesa në orët mësimore, pasi që numri i mungesave arrin shifrën në 100.000; mungon informata për kushtet e mësimit praktik, pasi që gjithmonë është problem në shkollat e mesme të larta çështja e mësimit praktik, dhe shtoi se ka ardhur një mjet për punën praktike që quhet "boks" për kafshë, dhe mjetin në fjalë e ka burgosur drejtori i shkollës, pasi që që dy vite mjeti rrin brenda, prandaj kërkoi që të jepet në shfrytëzim "boksi" për kafshë për ta ushtruar nxënësit më tepër praktikën; mungon informata për nxënësit me aftësi të kufizuara; mungon informata për transportin e nxënësve; mungon informata për nxënësit parashkollor; mungon informata për aktivitete të lira të nxënësve; mungon informata për realizimin e ekskursioneve për maturantët; mungon informata për suksesin dhe kuadrin mësimdhënës për disa lëndë deficitare, duke pyetur se a ka tekste mësimore për këto lëndë profesionale, pasi që deri më tani është degraduar mësimi, sepse është praktikuar vetëm marrje e shënimeve; mungon informata se si po zhvillohet procesi mësimor në shkollat Prelluzhë, Gracë dhe Gojbulë. Në fund kërkoi nga Drejtoria për Arsim që në të ardhmen ta informon komunën për tërë aktivitetin e një gjysmëvjetori shkollor.

Vlora Qirezi, anëtare e kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se suksesi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta i konsiderueshëm, dhe shtoi se kjo kalueshmëri e lartë në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta për çdo vit është pothuajse e njëjtë, pastaj këta nxënës vazhdojnë shkollimin e mesëm të lartë, kurse suksesi i nxënësve në shkollat e mesme të larta është: në gjimnaz 56.74 % kanë sukses negativ; në shkollën e mesme teknike 71 % kanë sukses negativ; në shkollën e mesme profesionale 62.82 % kanë sukses negativ, prandaj nga këto statistika nënkuptohet që gjendja është mjaft shqetësuese, prandaj duke u bazuar në suksesin e nxënësve të shkollave të mesme të larta, Drejtoria për Arsim duhet të ndërmarrë masa për ndryshimin e kësaj gjendjeje. Në fund tha se pasi që procesi i notimit është një komponent me rëndësi, duhet të bëhet përpjekje për të ndryshuar mënyrën e notimit, dhe propozoi që të organizohen trajnime për një numër të caktuar të mësimitdhënësve lidhur me metodat e notimit.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se nga suksesi i të gjitha shkollave fillore, 95.32 % janë me sukses pozitiv, prandaj krahasuar me vitin 2010/2011 suksesi pozitiv ka një rënie për 0.93 %, dhe shtoi se kjo përqindje e paraqet një vlerësim real nga ana e mësimitdhënësve. Pastaj tha se

përqindja e ultë vjen nga nxënësit që kanë probleme familjare dhe gjendje të rëndë ekonomike, por ka edhe nxënës me ngecje mendore. Në vazhdim tha se përqindjen e ultë e shkaktajnë nxënësit që nuk dinë shkrim dhe lexim, prandaj e përshëndeti Grupin joformal të femrave- anëtare të kuvendit, të cilat kanë marrë iniciativë për ta ndihmuar këtë kategori të nxënësve. Mandej tha se koncepti i ri i mësimdhënies bashkëkohore ka ndikuar pozitivisht, pasi që roli i mësuesit është koordinator, këshilltar, stimuluues, lehtësues, udhëzues dhe orientues në procesin mësimor, dhe si rezultat i kësaj qasje, nxënësi është bashkëpjesëmarrës në të gjitha aktivitetet.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në shkollimin fillor nuk është suksesi real, prandaj duhet angazhuar një ekip të tërë për të gjetur zgjidhje se si të dilet nga kjo krizë, dhe njëkohësisht kërkoi të ketë një gjendje reale lidhur me notimin në shkollimin fillor, pasi që ka nxënës që nga shkollat fillore vijnë me sukses të shkëlqyeshëm në gjimnaz, ku të njëjtët pastaj mbesin me mbi 5 nota të dobëta. Pastaj tha se në gjimnaz para disa viteve ka pasur pranim të nxënësve pa kriter, dhe kjo shkëlqje e kriterit po rezulton me sukses jo të mirë në shkollën e mesme, dhe shtoi se me kalimin e kohës, ngritja që ka ndodhur në 9.51 % në gjimnaz do të jetë shumë më e lartë, pasi që me kalimin e gjeneratave të pranura pa kriter do të jetë një gjendje edhe më e mirë e suksesit të nxënësve. Në vazhdim tha se në shkollën profesionale dhe në shkollën teknike ka një rënie të suksesit të nxënësve, e cila po ndodh për çdo vit, prandaj kërkoi që të bëhet një analizë për këto dy shkolla pse po ndodh rënia e rezultatit, duke shtuar se kjo rënie e rezultatit po ndodh si pasojë e mosorganizimit të duhur nëpër drejtoritë e këtyre shkollave. Mandej tha se ka raste kur drejtorët zgjidhen sipas përkatësisë politike, mirëpo kur është në pyetje interesi i përgjithshëm kombëtar, ka rëndësi që në krye të shkollave të vendosen njerëz që mund të çojnë proceset përpara, pasi që bëhet fjalë për 1500 – 1800 nxënës, po ashtu kërkoi që në dy shkollat në fjalë të rishikohet kuadri, pasi që kuadri ka ndikuar në rënien e rezultatit që po ndodh për çdo vit. Në fund lidhur me punëtorët teknik të tri shkollave të mesme, që kanë kaluar në kompani private, tha se vazhdimisht iu ndalen nga 11 € nga pagat e tyre për trustin pensional, kurse kompania private në të cilën kanë kaluar punëtorët teknik, nuk i bartë mjetet e tyre në trustin pensional, prandaj kërkoi që të ndërmerren masa në rregullimin e çështjes në fjalë.

Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit- duke iu referuar mjetit për punë praktike të quajtur “boks”, tha se “boksi” është donacion nga “Danida” për shkollën e bujqësisë, dhe profesorët adekuat (veterinarët) mund ta shfrytëzojnë atë një apo dy ditë nëpër ferma, por duhet kthyer përsëri në shkollë, pasi nuk lejohet t’i dhurohet ndokujt, pasi që është donacion i dedikuar për nxënësit e shkollës. Në fund sqaroi se “boksi” shërben për mënjanimin e thundrave të shtazëve.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se nuk është i kënaqur me suksesin e nxënësve, dhe është shqetësues niveli i suksesit pozitiv në të gjitha shkollat e mesme, sukses i cili sillet rreth 34 %, 25 % dhe 42 %, dhe nga kjo nënkuptohet se as 50 % e nxënësve nuk janë mjaftueshëm të arsimuar, dhe shtoi se ky sukses është tregues i nivelit të përgatitjes së pamjaftueshme të mësimdhënësve tanë. Pastaj tha se edhe në këtë rezultat aktual të suksesit të nxënësve bëhen lëshime dhe fryrje. Në vazhdim tha se po mbushen 4 vite që shkollat presin për t’u emëruar, siç janë: shkolla fillore e mesme e ultë në Lumadh; shkolla fillore e mesme e ulët në Mihaliq; shkolla fillore e mesme e ulët në Nedakoc; shkolla fillore e mesme e ulët në Reznik; shkollat e mesme të ulëta 1 dhe 2 në Vushtrri. Kurse shkollat që presin për t’u riemërtuar janë: SHMU “Adem Voca” në listën e pagave figuron me emrin SHFMU “Zenel Hajdini” në Sumë; SHFMU “Lumni Surdulli” në listën e pagave figuron me emrin SHFMU “Muhamet Kyçyku - Cami” në Samadrexhë; SHFMU “Mustafë Shyti” figuron me emrin SHFMU “Ruzhdi Bytyqi” në Ashlan; SHF “Naim Frashëri” figuron me emrin SHF “Zija Prishtina” në Vushtrri; SHFMU “Nazmi Zhegrova” figuron me emrin SHFMU “Shkëndija” në Stanoc të Poshtëm (Buzëlum);

SHFMU “Rexhep Musa” figuron me emrin SHFMU “Hivzi Sulejmani” në Ceceli; SHFMU “Rrustem Hyseni” figuron me emrin SHFMU “Bejtullah Hyseni”; shkolla e mesme e lartë – gjimnazi “Eqrem Çabej” figuron në listën e pagave SHML – gjimnazi “Muharrem Bekteshi” në Vushtrri; shkolla e mesme teknike “Lutfi Musiqi” figuron me emrin SHMT “Marin Beçikemi” në Vushtrri; ndërsa dy shkolla edhe pse janë emërtuar dhe riemërtuar, në listën e pagave figurojnë njëra SHFMU në Dobërlukë (SHFMU “Latif Berisha”), kurse SHMP “Bahri Haxha” vazhdon në listën e pagave me emrin SHMP “Latif Berisha” në Vushtrri.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me shfrytëzimin e “boksit”, tha se është dashtë të gjendet gjuhë e përbashkët e këshillit profesional të shkollës, dhe shtoi se shqetësimi i tij është se po vijnë mjete mekanike për praktikë, por nuk po bëhet praktikë.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- tha se Drejtoria për Arsim ka më së shumti buxhet, por edhe më së shumti probleme, dhe shtoi se suksesi prej klasës 1-5 është i mirë, mirëpo është shqetësuese që ky sukses në vazhdim shënon rënie, dhe kjo vjen si rezultat i stafit menaxhues të shkollave dhe të mësimeve, pasi që ka raste që në shkollat e Vushtrrisë ka mësime me të meta psikike dhe fizike. Pastaj përmendi rastin kur në shkollën e mesme profesionale, një profesor që pretendon se DA-ja ia ka borxh 9.000 €, dhe si rezultat i këtij pretendimi, ai iu hakmerret nxënësve, duke mos i notuar. Në vazhdim tha se në fshatin Stanoc, një profesor i edukatës qytetare e ka lëshuar procesin mësor që dy muaj, pastaj është hapur konkursi, dhe i njëjti është prishur, dhe si pasojë nxënësit mbi një muaj kanë humbur orë mësimore, gjithashtu edhe në fshatin Smrekonicë ka humbur një normë e plotë për një muaj, prandaj kjo papërgjegjësi dhe neglizhencë e profesorëve po e dëmtojnë procesin mësor. Në fund lidhur me pranimin e nxënësve në gjimnaz, tha se është kundër kriterit që nota mesatare për pranim të jetë 4.5, pasi që nuk është ky një kriter i qëndrueshëm, sepse këtë po e dëshmon rezultati i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- duke iu referuar gjendjes së arsimit në Komunën e Vushtrrisë, tha se simpoziumet në favor të arsimit duhet të mbahen në nivel të Kosovës, pasi që ky sukses është gati në tërë Kosovën, dhe shtoi se MASHT-i duhet ta korrigjojë testin e maturës për formën e përpilimit, pasi që ka vërejtje nga mësimeve që përmbajtja e testit të maturës është e ngjashme si për gjimnazin, ashtu edhe për shkollat teknike, gjithashtu të analizohet forma e mbajtjes dhe e vlerësimit të testit në fjalë, sepse në shkollën teknike “Lutfi Musiqi” ka pasur rast që nxënësi me vështirësi e ka kaluar testin e maturës, kurse tani është student i dalluar në fakultet. Në fund tha se kur të bëhet pranimi i nxënësve në shkollat e mesme, përveç kriterëve tjera, paraprakisht të testohen nxënësit se a dinë shkrim-lexim.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, kërkoi që në të ardhmen të emërtohet “Informatë mbi gjendjen e arsimit në Vushtrri”. Pastaj tha se në shkollën fillore janë 5 nxënës të pa notuar, kurse në shkollën e mesme të ulët janë 20 nxënës, prandaj pyeti drejtorin e Drejtorisë për Arsim se ku janë këta nxënës?

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- tha se informata në fjalë është paraqitur në mënyrë të kompletuar, kurse lidhur me suksesin jo të mirë të nxënësve në shkolla, kërkoi që të gjendet një strategji që në vitet tjera të ndërmerren masa për ta ngritur suksesin dhe cilësinë në arsim. Pastaj paraqiti papajtueshmërinë e vet lidhur me atë që u tha se Drejtoria për Arsim ka më së shumti buxhet dhe më së shumti probleme, pasi që për arsim cilësor nevojitet edhe një bazë e fortë materiale. Në fund lidhur me notimin joreal, kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që të merren masa ndaj mësimeve që kushtëzojnë notimin e nxënësve në shkolla, me pjesëmarrjen e nxënësve në kurset private.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se do të ishte mirë të paraqitej një pasqyrë e plotë për secilën shkollë se si ka punuar në tërë

Komunën e Vushtrrisë, dhe në bazë të saj të kuptohet se kush po mundet ta menaxhojë si duhet shkollën, dhe për ata që kanë rezultate të dobëta, duhet të ekziston institucioni i llogaridhënies, prandaj kërkoi nga Drejtoria për Arsim që në informatat e ardhshme të paraqesë pasqyrë konkrete për secilën shkollë. Në fund kërkoi që të zbatohet edhe institucioni i shpërblimit për ata që kanë punuar mirë.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- duke iu referuar pyetjeve dhe vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me informatën në fjalë, tha se suksesi i dobët i nxënësve në shkollat teknike po ndodh për shkak se që 2 vite nuk ka mbetur në rrugë asnjë nxënës që përfundon shkollën fillore. Kurse sa i përket “boksit” dhe pajisjeve tjera për praktikë, ato do të jenë nën menaxhim të shkollës, dhe nuk do të lejohet që pajisjet e shkollës të shfrytëzohen për biznese private. Lidhur me klasën e nxënësve me aftësi të kufizuara, tha se klasa nuk është më në barakë, por është vendosur brenda lokalit të shkollës “Ali Kelmendi”. Ndërsa në shkollat që mësimi zhvillohet në gjuhën serbe është shpallur konkursi për vendet e tyre të punës. Pastaj tha se mungojnë trajnimet e mësimdhënësve në shkollat e mesme, pasi që aty edhe kuadri nuk është i pranuar me kualifikime përkatëse, në mungesë të kuadrit, duke shtuar se për ta çdo vit hapet konkursi. Në vazhdim njoftoi se Komuna e Vushtrrisë është e para në nivel të Kosovës që ka ndërtuar Qendrën e Trajnimeve Bazike, ku do të fillojë trajnimi i mësimdhënësve sipas metodologjisë së USAID-it. Lidhur me analfabetizmin e nxënësve, tha se në bashkëpunim me Grupin joformal të femrave deputete jemi duke kompletuar të dhënat, dhe njoftoi se në shkollën “Mustafë Venhari” janë 16 nxënës analfabetë, në shkollën “Naim Frashëri” janë 5 nxënës analfabetë, kurse në shkollën “Ali Kelmendi” janë 18 nxënës analfabetë. Mandej lidhur me zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, tha se në asnjë rast nuk janë zgjedhur drejtorët sipas përkatësisë partiake, por drejtorët janë profesional dhe janë zgjedhur sipas kriterëve të konkursit. Kurse lidhur me emërimin dhe riemërimin e shkollave, tha se gjatë muajit dhjetor i ka dërguar të gjitha kërkesat me dokumentacion të kompletuar për emërimin e shkollave të cilat janë të paemëruara, dhe procedura ka mbetur në MASHT-në, dhe njëkohësisht ka dërguar edhe të gjitha kërkesat e shkollave të cilat kanë vendimet nga Drejtoria për Arsim, e të cilat nuk janë ndërruar në listën e pagave. Ndërsa lidhur me borxhin e pretenduar nga profesori i historisë, tha se DA-ja nuk i ka asnjë cent borxh drejtorit në fjalë. Në vazhdim tha se deri sa të shpallet konkursi, orët mësimore të “edukatës qytetare” në Stanoc i mban drejtori i shkollës, pasi që është me profesion historian. Lidhur me mbajtjen e simpoziumit, tha se është kompetencë e MASHT-së organizimi i tij. Gjithashtu njoftoi se Drejtoria për Arsim ka formuar një komision, i cili është duke përgatitur një kuiz, të cilit do t’i nënshtrohen të gjithë nxënësit, duke filluar nga klasa e VI – IX-tën, dhe me përfundimin e këtij testimi, do të nxirret një gjendje reale lidhur me nivelin e arsimit në Komunën e Vushtrrisë. Ndërsa lidhur me nxënësit e pa notuar, tha se kjo vjen si rezultat i lëvizjes së nxënësve prej një shkolle në shkollën tjetër, dhe mos bartjes së informatave për lëvizje të tilla. Pastaj tha se asnjë ankesë nuk ka në Drejtorinë për Arsim se ndonjë nxënës është kushtëzuar prej ndonjë mësimdhënësi për mbajtjen e kurseve private. Po ashtu tha se herëve tjera do të ketë informatë për kuvendin e komunës lidhur me rezultatet e secilës shkollë. Në fund njoftoi se Drejtoria për Arsim deri në muajin qershor do ta finalizojë përpilimin e historikut për secilën shkollë dhe të botohet në formë të një libri, duke shërbyer si burim i informacionit për shkollat e Komunës së Vushtrrisë, gjithashtu njoftoi se do të formohet Shoqata e Veteranëve të Arsimit, e cila do të jetë pjesë e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Vushtrrisë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar shkollimit fillor të ulët dhe shkollimit fillor të mesëm, propozoi tani për tani një zgjidhje, duke thirrur të gjithë arsimtarët dhe drejtorët e shkollave, kryetarin e komunës dhe përfaqësuesit nga Ministria e Arsimit për të organizuar një takim të përbashkët, duke kërkuar nga ta një sinqeritet rreth notimit real të nxënësve.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë, (shqyrtimi i parë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se edhe Komuna e Vushtrrisë ka nevojë që ta ketë një rregullore e cila e rregullon këtë lëmi. Kurse në vazhdim paraqiti këto vërejtje: te neni 10 thuhet se të afërmit janë të obliguar ta mirëmbajnë varrin, prandaj nëse e mirëmbajnë varrin familjarët, atëherë obligimi te neni 23 .2 i vë në dilemë qytetarët për të bërë marrëveshje me ndërmarrjen shërbyese për varrim; te neni 14, kur në të njëjtin nen i referohet nenit 14, duhet në vend të nenit 14, t'i referohet nenit 13; te neni 14.7 pyeti a ka mundësi NSHV-ja t'ua ndalon ndërtimin, apo duhet ta lajmëron organin kompetent komunal, i cili është organ ekzekutiv, prandaj kërkoi që kjo fjali të riformulohet; te neni 19, kërkoi që të precizohet, për shkak se len hapësirë që edhe vet të bëjë bartjen e kufomës, pa e njoftuar NSHV-në; neni 33.2 nuk duhet të ekziston, por nëse nuk hiqet, propozoi që të futet edhe një paragraf me këtë përmbajtje: “varrezat e karakterit monumental-historik duhet të jenë të përhershme” dhe nuk duhet t'i nënshtrohet nenit në fjalë; te neni 41, tha se është e pamundur ligjërisht të realizohet, pasi që komplet të hyrat që inkasohen nga komuna, derdhen në një vend; neni 48.4 dhe 49.3 duhet të harmonizohen, sepse të dytë i referohen të njëjtit nen, por shumat nuk janë të njëjta.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se draft-rregullorja në fjalë e ka një rëndësi të veçantë, pasi që e rregullon një çështje shumë të rëndësishme, dhe shtoi se kjo rregullore e rrit koston e investimit të ceremonisë së varrimit të çdo familje, kurse shumë kuvende komunale kanë marrë vendim për t'i përkrahur familjet, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, duke ua hequr shpenzimet të gjithë atyre që kanë raste varrimi gjatë një viti kalendarik, prandaj është mirë që edhe Komuna e Vushtrrisë të mendojë për këtë iniciativë. Në vazhdim tha se gjatë diskutimit publik të draft-rregullores në fjalë, përfaqësuesit e Drejtorisë për Shërbime Publike duhet të organizojnë debate të mirëfillta publike, sidomos me grupe të interesit dhe me Bashkësinë Islame, në mënyrë që të bëhet një rregullore funksionale dhe e zbatueshme. Në fund tha se edhe kuvendi i komunës për ta zbatuar këtë rregullore, së pari duhet të investojë në rregullimin e varrezave, sidomos të atyre në fshatin Begaj.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar nenit 27.1 të draft-rregullores në fjalë, tha se varrosja bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore si dhe rregullat fetare, duke respektuar dinjitetin e të vdekurit. Kurse lidhur me nenin 27.2, tha se është një kolizion në korelacionin e ekspertizës mjeko-ligjore në aspektin profesional, pasi që afati i obligueshëm sanitar është 10 vite, mirëpo nëse kërkohet ekspertiza mjeko-ligjore për identifikimin e kriminit dhe fajit, kjo nuk vlen, pra i nënshtrohet procedurës ligjore sipas akteve normative që shteti i ka në dispozicion.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë paraqiti këto vërejtje dhe propozime: te neni 2, propozoi që të hyn edhe nocioni “varrezat e dëshmorëve dhe varrezat e martirëve”, gjithashtu propozoi që të hyjnë në këtë nen edhe lapidarët; te neni 4, propozoi që të shtohet paragrafi 4.3 me këtë përmbajtje “një fshat me të njëjtin besim, nuk mund t'i ketë dy vendvarrime”, dhe shtoi se nuk është mirë që një fshat t'i ketë 2-3 vende për varrime, me përjashtim nëse ka banorë të besimeve të ndryshme, gjithashtu propozoi që në vend të termit “konfeksion” të përdoret termi “besim; nenit 9.2 t'i shtohet edhe fjalia “varrezat e martirëve”, dhe propozoi që në vend të emërtimit “viktima të luftës” të përdoret “varrezat e martirëve”; te neni 17.15 të përmenden edhe varrezat e martirëve; te neni 22, propozoi që Bashkësia Islame të jetë bashkëpunuese dhe të merren parasysh propozimet e saj. Kurse lidhur me konservimin e varrezave, tha se duhet menduar se si të veprohet, kur bëhet fjalë për varret e martirëve, pasi që në varrezat e vjetra të qytetit ka edhe varre të martirëve. Mandej te neni 35, kërkoi që të hiqet ky nen që

flet për mbajtjen e rendit gjatë ceremonisë së varimit. Në fund propozoi që të hiqet në tërësi neni 26, gjithashtu në rregulloren në fjalë propozoi të figuron emërtimi “varrezat e besimit musliman”.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se është pozitive hartimi i draft-rregullores në fjalë, pasi që do ta trajton problemin e kahmotshtëm dhe do ta rregullonte me ligje çështjen e varrezave. Pastaj pyeti se cilat janë obligimet që i ka komuna dhe cilat janë obligimet që i merr bashkësia fetare, pasi që këtu shpeshherë ka ngatërresa, gjithashtu pyeti se qytetarët sa kanë obligime nga komunës dhe çka kanë obligime ndaj bashkësisë fetare, pasi që ka raste kur bashkësia fetare i merr obligimet të cilat do të duhej të ishin të komunës, prandaj nëse hyn në fuqi kjo rregullore, duhet kuptuar që krijohen obligime ndaj komunës. Ndërsa te neni 14.3, propozoi që në vend të termit “ale” të përdoret termi “rrugica”. Te neni 26, tha se akoma nuk ekzistojnë kushtet për t’u zbatuar djegia e eshtrave, pasi që krematoriumet kërkojnë shpenzime të jashtëzakonshme, prandaj propozoi që të hiqet neni në fjalë. Në fund lidhur me konservimin e varrezave, tha se 70 vjet janë shumë për t’u ruajtur një varrezë, prandaj propozoi të jetë 40-50 vjet, sepse nuk mund të ketë në mes të qytetit varrezave që janë të konservuara për 70 vjet.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, lidhur me nenin 15.2, tha se në vend të fjalisë “kuvendi i komunës” të thuhet “komuna”. Mandej tha se neni 25.2 është i pakuptimtë, dhe duhet të riformulohet. Në fund duke krahasuar përmbajtjen e nenit 42.2 dhe nenit 17.6, tha se do të ishte mirë të thuhej: “të hartojë planin e punës për vitin e ardhshëm kalendarik, dhe propozimin ta dorëzojë përmes DSHP-së, kuvendit të komunës”.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë

Diskutimi publik fillon nga data 24.02.2012 dhe zgjatë deri më 16.04.2012.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Shukri Gërxhaliu, kryesues i KK për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- paraqitisqarimet hyrëse lidhur me raportin në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se raporti në fjalë e dëshmon shqetësimin e Grupit parlamentar të LDK-së, pasi që grupi parlamentar shpesh e ka ngrit çështjen se disa dokumente që vijnë në kuvend, nuk kalojnë përmes trupave që kuvendi i komunës i ka formuar me qëllim të ndihmesës në mënyrë profesionale. Pastaj tha se është shqetësuese që në raportin në fjalë për vitin 2010, komiteti konsultativ kërkon informim zyrtar dhe pajisje të komitetit me rregullore, projekte dhe punët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, dhe e njëjta kërkesë përsëritet edhe në vitin 2011, dhe shtoi se në këtë raport nuk është paraqitur asnjë e dhënë që tri planet rregullative të aprovuara nga kuvendi i komunës, kanë kaluar përmes komitetit konsultativ në fjalë, i cili kishte me qenë shumë kontribuues rreth planeve rregullative. Gjithashtu tha se as Rregullorja për Mbrojtjen e Ambientit nuk paska kaluar përmes komitetit konsultativ në fjalë, prandaj kërkoi nga kuvendi që në të ardhmen gjatë diskutimeve publike të drafteve të ndryshme, të merret në konsideratë përvoja dhe profesionalizmi i këtij komiteti.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- tha se është e nevojshme që të mbrohet mjedisi hapësinor, sepse ambienti ynë është shumë i kontaminuar dhe i rrezikuar. Pastaj pyeti se a ka mundësi që komiteti konsultativ në fjalë ta ketë një ekolog, pra ta inkorporon në rrjedhën e procesit të punës së vet për ngritjen e vetëdijes për ta mbajtur mirë mjedisin dhe ta ruajnë shëndetin tonë. Mandej kërkoi një sensibilizim për qytetarët përmes formave të ndryshme, duke propozuar që të bashkëpunohet

me shkollat dhe me të gjitha institucionet që janë bartëse në ndonjë mënyrë për ambientin tonë. Në fund tha se Vushtrria ka një potencial të madh, ka një tokë shumë të mirë pjellore.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, paraqiti vërejtje lidhur me këtë paragraf “Komiteti konsultativ mbështet kërkesën e kompanisë Uniteti për kushtëzimin e ofrimit të dëshmive për kryerjen e obligimeve ndaj kësaj kompanie me rastin e ofrimit të shërbimeve komunale”, dhe shtoi se nuk bën të rekomandohet diçka që është në kundërshtim me ligjin. Pastaj tha se duke pasur parasysh reshjet e fundit që kanë ndodhur, drejtoritë përkatëse në bashkëpunim me komitetin përkatës duhet të marrin masa për të pastruar rrugët dhe lumenjtë, me qëllim të parandalimit të shpërthimit të ndonjë epidemie me përmasa të papara.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se roli i këtij komiteti është shumë i rëndësishëm, prandaj propozoi që ky komitet, por edhe komitetet tjera kanë nevojë për mbështetje, sepse nëse bëhet pagesë e vogël, nuk duhet prituri rezultate të mëdha. Pastaj tha se ky komitet mund të ketë nevojë për të dalur në terren, për ta kuptuar gjendjen faktike, duke e incizuar gjendjen dhe mandej të bëjë raportime, duke specifikuar saktësisht se ku ka nevojë dhe prioritet të reagohet.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi që KV-Kosova (F) t'i ndahen 2.000 €. Gjithashtu propozoi që tifozëve “Forca” t'i ndahen 800 €, sepse në mesin e këtyre tifozëve ka shumë të rinj të cilët me angazhimin e tyre e pasurojnë jetën kulturore dhe sportive në qytetin e Vushtrrisë. Kurse lidhur me shumatat e parashikuara për shoqatat e ndryshme, propozoi që të balancohen shumatat.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që Shoqatës së Martirëve t'i rritet shuma, sepse 600 € janë pak, duke kërkuar që të nivelizohet shuma e kësaj shoqate me shoqatat tjera, kurse për shoqatën HANDIKOS propozoi që shuma totale të jetë 3.000 €. Në fund e mbështeti propozimin që edhe tifozëve “Forca” t’iu ndihmohet.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- tha se për Grupin parlamentar të femrave është dashtë të jetë shuma 10.000 €, pasi që kuvendi ka nxjerrë vendim për këtë shumë, e jo 5.000 € siç figuron në propozim-vendimin në fjalë, prandaj për këtë kërkoi sqarime.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- duke përkrahur propozim-vendimin në fjalë, kërkoi që klubet sportive të femrave gjithmonë të kenë prioritet, kurse tek rubrika “botimi i librave” propozoi që 500 € t’i ndahen Nysret Pllanës për librin “Gjenocidi serb”.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se shuma për subvencione ka qenë mbi 150.000 €, kurse në mungesë të mjeteve për mallra dhe shërbime, është dashtë që rreth 40.000 € të merren nga ky fond dhe të dedikohen për mallra dhe shërbime, dhe si rezultat i kësaj shuma e mbetur është 109.862 €. Pastaj tha se propozim-vendimi në fjalë është hartuar me qëllimin që të kanalizohen këto mjete, pasi që gjatë vitit po paraqiten kërkesa të ndryshme, kështu që po anashkalohen disa lëmi, që duhet të subvencionohen. Në fund lidhur me vërejtjen e B.Pllanës, tha se shuma nga 10.000 € ka rënë në 5.000 € për Grupin joformal të femrave deputete për shkak se me vendim të kuvendit është zvogëluar fondi i përgjithshëm i subvencioneve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se ky material nuk ka shkuar siç duhet përmes procedurave ligjore, sepse nuk ka kaluar përmes KPF-së. Pastaj tha se vendimi i kuvendit duhet të ndryshohet,

sepse ka qenë vendim i kuvendit për ndarjen e shumës prej 10.000 € për Grupin parlamentar të femrave. Në vazhdim tha se është johumane nëse trajtohen në këtë mënyrë, duke bërë një ndarje të tillë ndaj qindra e qindra martirëve të lirisë, prandaj kërkoi që të gjitha shoqatave t'iu ndahen shuma të mjeteve të përafërta me njëra tjetrën.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- paraqiti vërejtjen e tij që propozim-vendimin në fjalë me një shumë kaq të madhe të hollash nuk ka kaluar përmes KPF-së, duke thënë se një veprim i tillë është i pajustificueshëm, dhe shtoi se në propozim-vendimin në fjalë është urgjente nxjerrja e vendimit vetëm për pjesën ku flitet për ndihmë sociale familjeve skamnore, sepse këto janë mjete që janë shpenzuar apo janë duke u shpenzuar, sepse gjendja emergjente akoma vazhdon, kurse pjesët tjera është dashtë të jenë të planifikuara me kohë, dhe është dashtë të përcaktohen kriteret për ndarjen e këtyre mjeteve për secilin klub sportiv dhe shoqatë, gjithashtu nga këto klube dhe shoqata asnjëherë nuk kanë ardhur raportet mbi shpenzimet e tyre. Në fund tha se shumat për klubet sportive janë propozuar në bazë të simpative, por shtoi se në këtë mënyrë nuk i ndihmohet sportit dhe krijohet një rivalitet mes klubeve.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit- propozoi që të gjitha shoqatave të dalura nga lufta t'iu ndahen mjete në mënyrë të barabartë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar akuzës së V.Karaçës, tha se shumat e propozuara për klubet sportive nuk janë bërë në bazë të simpative, por është bërë mbi bazën e një analize të hollësishme. Kurse lidhur me vendimin për ndarjen e shumës prej 10.000 € për Grupin e femrave deputete, tha se nuk ka nevojë të anulohet vendimi në fjalë, sepse nëse ka mjete, qoftë edhe me rebalancë përsëri mund t'iu ndahen Grupit të femrave deputete.

Ergin Sungri, anëtar i kuvendit- kërkoi që sot të aprovohet vendimi në fjalë, pasi që klubet sportive janë në gjendje të mjerueshme. Gjithashtu kërkoi që në mbledhjen e radhës së KK-së të paraqitet raporti për vitin e kaluar për klubet sportive dhe shoqatat. Në vazhdim tha se është e vogël shuma e propozuar prej 600 € për Shoqatën "Martirët e Lirisë", prandaj kërkoi që të rritet kjo shumë. Po ashtu për Shoqatën e Peshkatarëve kërkoi që t'iu ndahen më shumë mjete.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- propozoi që të hiqet nga propozim-vendimi emërtimi "Fondi për komunitete", duke njoftuar se Komuna e Vushtrrisë është duke iu ndarë mjete komuniteteve, por edhe në të ardhmen do t'iu ndanë.

Qamil Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport- tha se muajt dhjetor, janar dhe shkurt janë muaj të vështirë edhe për bizneset, prandaj klubet sportive nuk mund të presin ndihmë gjatë këtyre muajve nga bizneset. Pastaj tha se për disa klube është urgjente që të aprovohet vendimi në fjalë, dhe si shembull për këtë përmendi klubin e basketbollit. Gjithashtu tha se klubeve sportive të femrave duhet t'iu ndahen shuma të njëjta, kurse edhe për shoqata kërkoi të bëhet një ekuilibrim.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- duke iu referuar fjalës së drejtorit të drejtorisë përkatëse, tha se nëse klubi i basketbollit ka nevojë për mjete, nuk ka faj kuvendi, por faji është i drejtorit që nuk ka planifikuar me kohë mjete për klubet. Në fund tha se të gjithë janë të interesuar për t'iu përkrahur klubet, por duhet bërë një përkrahje e barabartë dhe e ndershme në bazë të rezultateve që i kanë arritur dhe nivelit të garave që marrin pjesë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me ndarjen e të hollave për librin e Nysret Pllanës, tha se nganjëherë Komuna e Vushtrrisë jep të holla pa kurrfarë kriteri, dhe shtoi se ka shoqata dhe komisione që kanë punuar me vite për hulumtimin e krimeve të luftës, por asnjëherë nuk iu kanë drejtuar komunës për subvencion. Ndërsa duke iu referuar kërkesës së drejtorit për të aprovuar vendimin në fjalë, tha se mungojnë informatat rreth aktiviteteve të klubeve dhe të shoqatave.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar fjalës së S.Kadriut, tha se një pjesë e atyre që kanë punuar kinse në hulumtimin dhe zbulimin e krimeve të

luftës janë paguar, por në mesin e tyre nuk është Sabit Kadriu, dhe shtoi se nuk dihet që është ngritur ndonjë lëndë në Komunën e Vushtrrisë ndaj dikujt lidhur me këto çështje.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar propozimeve nga anëtarët e kuvendit, paraqiti këtë përmbledhje: KV-Kosova (F) u propozua t'i ndahen 2.000 €; tifozëve "Forca" 800 €; 6 shoqatave t'iu ndahen mjetet në mënyrë të barabartë; për librin e Nysret Pllanës të ndahet shuma prej 1.000 €; kurse mjetet për komunitetin pakicë të barten në pozicionin "ndihma tjera".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 14 vota "për", 12 "kundër" të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:

1.1 Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës - fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2012, në shumë prej 109.862 € të shfrytëzohen për destinimet e paraqitura si më poshtë:

1.1.1 Obligimet të pakryera nga v. 2011.....3.000 €

1.1.2 Për grupin parlamentar të femrave5.000 €

1.1.3 Për Klubet sportive të komunës(28.300 €), prej të cilave:

- **Kl. Basketbollit „Kosova“.....4.000 €**
- **Kl. Volejbollit „Kosova“ – femrat.....2.000 €**
- **Kl. hendbollit „Kosova“ meshkujt.....2.000 €**
- **Kl. hendbollit “Kosova” femrat.....2.000 €**
- **KV AS Vushtrria – meshkujt..... 500 €**
- **KF „Artakolli“..... 2.000 €**
- **KB“Vushtrria Basket” 1.000 €**
- **K.Shahut „Llamkos“ 800 €**
- **K SH „Shqiponja“ 800 €**
- **KV. Gjirmazisti..... 2.000 €**
- **Kl. Mundjes Kosova“..... 500 €**
- **K Boksit „Kosova“.....800 €**
- **Kl. Pingpongut „H.Prishtina“500 €**
- **KF. “Kosova“ 4.500 €**
- **KK-Box“Kosova“ 1.000 €**
- **KH Samadrexha.....2.000 €**
- **Tifozët “Forca”.....800 €**
- **Shoqata e peshkatarëve “Silnica”..... 300 €**
- **Shoqata e shurdh-memecëve.....500 €**
- **Muhamet Rama, veteran i atletikës..... 300 €**

1.1.4 Për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve..... 2.500 €

1.1.5 Për Shoqatën e Invalidëve2.500 €

1.1.6 Për Shoqatën e Veteranëve..... 2.500 €

1.1.7 Për Shoqatën e të Burgosurve Politik..... 2.500 €

1.1.8 Për Shoqatën e Martirëve “Martirët e Lirisë”.....2.500 €

1.1.9 Për Familjen e Selatin Gërzhaliut (Martiraj-ndihmë për ndërtim)..6.500 €

1.1.10 Për familjen e Xhavit Hazirit (Druar – ndihmë për ndërtim).....6.500 €

1.1.11 Për Familjen e Agim Saraçit (Vushtrri – ndihmë për ndërtim).....6.500 €

1.1.12 Botim të librave..... 3.000 €

1.1.13 Ndihmë Sociale-Miell (familjeve skamnore)..... 10.000 €

1.1.14 Ndihma tjera (shërim, strehim etj.)..... 23.062 €

1.1.15 Për Arsim (transport të nxënësve me aftësi të kufizuara)..... 3.000 €

1.1.16 Shoqatës “Hendikos”2.500 €

Gjithsejt:.....109.862 €

Mjetet në shumën e cekur shpërndahen në bazë të kritereve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale Entiteteve Publike dhe jo Publike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione të cilat me vendim të kuvendit të komunës iu janë nda në vitin 2011.

7. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Informatës për pastrimin e rrugëve lokale nga bora në Komunën e Vushtrrisë, gjatë periudhës emergjente.

Naim Hyseni, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me informatën në fjalë. Në fund në emër të Shtabit Emergjent në pajtim me krytarin e komunës, i propozoi kuvendit të komunës që t’iu ndajë mirënjohje të gjitha kompanive për angazhimin e tyre në tejkalimin e gjendjes dhe krijimin e mundësive për qarkullimin e lirë të të gjithë qytetarëve.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është pozitive që gjendja në komunë nuk është dramatike, por është shqetësuese që në disa vende si: tek Ura e Sitnicës, duke përfshirë edhe shëtitoren, dhe tek ura mbi lumin “Tërstena”, në kanalin nën palestër sportive ku qytetarët e pandërgjegjshëm e kanë mbushur me borë dhe me mbeturina, prandaj kërkoi që të ndërmerren masa për t’u ndaluar këto forma që janë të rrezikshme për vërshime, por edhe dëmtojnë imazhin e qytetit.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- përgëzoi punën e Shtabit Emergjent për angazhimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë fazës emergjente, duke shtuar se çdo veprim i ndërmarrë ka qenë në përputhje me ligjin. Pastaj tha se situata emergjente është menaxhuar shumë mirë dhe jeta e qytetarëve ka funksionuar. Në vazhdim tha se përveç ndarjes së mirënjohjeve për kompanitë, duhet shikuar mundësitë edhe për kompensim material të një pjese të punës së tyre, pasi që kanë angazhuar tërë mekanizmin posedues, dhe një staf që ata e kanë paguar.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke e vlerësuar pozitivisht informatën në fjalë, tha se në vend se të shpërblehen këto kompani me mirënjohje, propozoi që këto kompani kur të konkurrojnë në të ardhmen për tenderët e ndryshëm, të kenë prioritet. Gjithashtu propozoi që në kuadër të shoqatave që iu ndanë mjete, të merret parasysh ndarja e mjeteve edhe për Kryqine Kuq të Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- e vlerësoi pozitivisht menaxhimin e situatës emergjente në Komunën e Vushtrrisë, e cila ka zgjatur 3 javë, dhe në këtë rast falënderoi: të gjithë punëtorët që kanë qenë pjesë e Shtabit të Emergjencës; Veli Karaçën; të gjitha kompanitë që kanë ndihmuar Komunën e Vushtrrisë; shumë vullnetarë tjerë që në forma të ndryshme kanë dhënë kontributin e tyre; Kryqin e Kuq të Vushtrrisë; punëtorët e QKMF-së. Në fund shprehu pajtimin që të gjithë kontribuuesve në fjalë t’iu ndahen mirënjohje, por edhe në rastet e tenderëve, duke respektuar procedurat ligjore, t’iu ipet përparësi kompanive që kanë ndihmuar gjatë kësaj faze emergjente.

Ferit Idrizi- propozoi që kontribuuesve të fazës emergjente në Komunën e Vushtrrisë t’iu ndahet nga një falënderim, kurse drejtorja t’iu lëshojë nga një referencë për kontributin që kanë dhënë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim autorizohet kryetari i komunës duke u bazuar edhe në nenin 67.1 “e” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, që të ndan falënderime për kompanitë

dhe OJQ-të “Koha” dhe “Forca” që kanë bërë pastrimin e rrugëve lokale nga bora, gjatë periudhës emergjente, në Komunën e Vushtrrisë.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës.

Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, vendosi me sa vijon:
Me këtë vendim lejohet transferimi i mjeteve në shumën prej 43,000.00 €, nga kategoria e investimeve kapitale, programi 644660, Planifikimi Urban dhe Mjedisor, kodi i projektit 86183, asfaltimi i rrugës “Dëshmorët e Kombit”, shuma e projektit 870,000.00€.

Shuma e cekur (43,500.00 €) transferohet në këto programe buxhetore:

- **Kodi 180, në Drejtorinë për Shërbime Publike në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, në shumën prej 33,500.00 €;**
- **Kodi 730, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në kategorinë subvencione dhe transfere, në shumën prej 10.000.00 €.**

c. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- reagoi lidhur me fletoret që iu janë dhuruar anëtarëve të kuvendit në rastin e ndërrimit të viteve, duke shtuar fjalët e urta që gjenden në ato fletore e fyejnë dhe denigrojnë dinjitetin e gruas, dhe kërkoi që ata që i kanë sjellur këto fletore të kërkojnë falje publikisht.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi raport të shpenzimeve të deshifruara për vitin fiskal 2011.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës së kuvendit për vitin 2012, tha se në masë të konsiderueshme shumë vërejtje dhe sugjerime të anëtarëve të kuvendit nuk janë të përfshira në planin në fjalë, dhe si shembull përmendi se mungon fjalimi i kryetarit të komunës në rastin e përfundimit të vitit kalendarik. Gjithashtu në planin e punës së kuvendit mungon plani vjetor i punës dhe raporti vjetor i kryetarit. Pastaj tha se ka mbledhje që është shumë e ngarkuar, kurse ka muaj që i ka vetëm dy pika të rendit të ditës.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- pyeti lidhur me 18 punëtorët teknik të tri shkollave të mesme, ku sipas kontratave të tyre, duhet ta gëzojnë të drejtën e pensionit, por këtë të drejtë që 6 muaj po ua mohon kompania, prandaj kërkoi që punëtorëve në fjalë t’iu paguhet trusti pensional. Pastaj pyeti se sa qytetarë të Komunës së Vushtrrisë kanë kërkuar heqjen e shtetësisë së Kosovës? Në fund pyeti sa është numri i të vdekurve në regjistrat civil të pa çregjistruar për vitet 2007 – 2009?

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me çështjen e punëtorëve teknik, të cilët gjenden nën menaxhimin e një kompanie private, tha se komuna ka kontratë me kompaninë, dhe njoftoi se ka pasur një takim me disa nga punëtorët teknik, me ç’rast e kanë informuar për problemet me të cilat po ballafaqohen, dhe shtoi se në momentin kur komuna lidh kontratë me një kompani, të drejtat e atyre punëtorëve janë të rregulluar me ligj, kurse komunës i intereson menaxhimi i punës së kontraktuar me kompaninë. Në fund tha se nga kompania ka marrë konfirmimin se ua ka paguar të gjitha obligimet punëtorëve teknik.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar çështjes së punëtorëve teknik, tha se i ka parë dy lloje të kontratave, njëra për të njëjtën etapë kohore, kurse tani kërkohet kontrata e re, në mënyrë retroaktive në rastin e bartjes së punëtorëve, pasi që sipas kontratës së parë të nënshkruar thuhet se ata do të punojnë në qendrat shkollore ku kanë qenë, ndërsa në kontratën e dytë thuhet se do të dërgohen punëtorët aty ku ka nevojë në nivel të regjionit, prandaj nëse në të njëjtën kohë ekzistojnë dy kontrata, kjo nënkupton se po luhet me dinjitetin e tyre, dhe për këtë

arsye kërkoi në rastin konkret të vlerësohet ligjshmëria. Mandej tha se gjatë diskutimit për planin e punës, është dhënë propozimi që të ketë raporte edhe nga komitetet tjera, prandaj kërkoi që të raportohet për punën e KKS-së në mbledhjet e ardhshme të KK-së, duke e paraqitur të nevojshme që kur të debatohet për çështjen e sigurisë, në mbledhje të KK-së të jetë prezent edhe komandanti i policisë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- paraqiti vërejtje rreth planit të punës, pasi që kur është debatuar për planin e punës së kuvendit, ka propozuar që të hyn edhe propozim-vendimi për ndryshimin e Rregullores së punës së kuvendit dhe organeve të tij, por propozimi në fjalë nuk është në planin e punës. Pastaj në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që për mbledhjen e ardhshme të paraqitet raport mbi mënyrën se si janë shpenzuar mjetet që iu janë ndarë klubeve dhe shoqatave gjatë vitit 2011.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me ndarjen e mjeteve për klube dhe shoqata, tha se ka kërkuar që asnjë klubi dhe asnjë shoqate të mos i ipen mjete të reja, nëse nuk ka sjellur raport të shpenzimeve të mjeteve të vitit të kaluar.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

Lektore:
Vlora Krasniqi